

Oral History Kosovo

Në Kujtim të Antonella Giorgioni Pronare Restorani (1956-2017)

Antonella Giorgioni: Unë jam lindur në vitin '56, më 8 nëntor të '56, nga një familje shumë e thjeshtë. Babai im vinte nga tetë vjet luftë, nëna ime ishte, nuk do të thoja gjysëm-analfabete, por kishte përfunduar vetëm klasën e dytë, njëlloj edhe babai im. Pasi që u kthye nga lufta atij iu desh t'i përvishte mëngët, tashmë ai kishte një vajzë, motrën time të madhe, dhe u bë minator. Ai punoi në një minierë sulfuri për Motecatinin e vjetër që më vonë u bë Montedison. Fatkeqësish unë njoha vetëm një gjyshe sepse të tjerët kishin vdekur para se të lindesha unë, sidoqoftë familja ime dhe i gjithë rrathi, e tërë familja ime, kushërinjtë, të gjithë, ishin familje e varfër, një familje gjysmatarësh, që do të thotë, skajshmërisht të varfër.

Gjatë shkollës, unë isha militante e një grupei radikal të majtë të quajtur Lotta Continua [Përpjekja Vazhdon], aty ne shpërnanim trakte nëpër fabrika, piketonim skollat, protestuam ndaj luftës në Vietnam, sidoqoftë ishim të gjithë nën përcjellje politike dhe për ato tri vjet, unë isha pjesë e Lotta Continua deri në lindje të feminizmit, ne, gratë e Lotta Continua mbajtëm një takim në Romë dhe u ndamë për t'iu bashkuar feminizmit.

Me t'u kthyer në shpi nga Ravenna, nga shkollimi në Ravenna, unë fillova të aktivizohem ngapak në Partinë Komuniste të fshatit tim, në degën e Partisë Komuniste, në një fshat Katolik, ata votuan Demokracinë Kristiane. Dhe pastaj thashetheme pas thashethemeve, se unë isha e dashura e njërit ose flija me njërin apo me atë tjetrin, të gjitha llojet e gjérave, e dini, gratë e moshuara të fshatit nuk kanë asgjë për tjetër për të bërë, vetëm bla bla bla...Punova për një periudhë të caktuar në degën e Partisë Komuniste dhe pastaj me grupin feminist UDI [Unione delle Donne Italiane, Unioni i Grave Italiane], i cili ishte pjesë e Partisë, pjesa feministe e Partisë Komuniste.

Pastaj do të doja t'u shpjegoja gjeneratave të reja se çka ishte feminizmi për ne. Njeriu duhet të konsiderojë se në kohën kur feminizmi lindi në Itali, gratë ishin shumë...siç e thashë edhe më parë, fakti që unë punoja në degën e Partisë Komuniste do të thoshte se unë isha grua e shturur, fakti se aty kishte vetëm burra dhe unë isha e vëtmja gruaja...feminizmi për ne përfaqësonte një liri, liri për të qenë shoqë me djemtë, për tu ndjerë më të lira. Ne nuk mund të dilnim në mbrëmje me djem, neve na duhej të ishim në shtëpi në orën 10 pasdarke. Ne nuk mund të dilnim të hanim pixca me shoqëri, ishte e pamundur.

Dhe kjo është e gjitha për sa i takon kohës kur unë isha vajzë e re, por feminizmi përfaqëson shumë përpjekje të tjera, do të thotë abortin, divorcin, pavarësinë, të drejtën e punës, të mos pasurit gjithmonë një shef burrë, mundësinë për të krijuar karrierë. Ky ka qenë tregimi i feminizmit.

Qëndrova në Shqipëri për tetë vjet dhe do të doja të shpjegoja se pse qëndrova atje për tetë vjet. Më pëlqeu Shqipëria menjëherë. Fillimisht, njerëzit lëviznin vetëm në këmbë, dhe pasditeve ishte një rrymë e njerzve që fillonte nga muzeu, vazhdonte poshtë tek universiteti dhe pastaj ngjitej lart në anën tjetër, praktikisht ata ecnin përgjatë këtij itinerari dhe kjo gjë ishte e bukur. Nuk kishte makina, siç thashë, unë isha e vëtmja që kishte makinë, kishte vetëm disa makina dhe njerëzit ishin kuriozë, tepër kuriozë, sepse ata nuk diinin pothuajse asgjë rreth Italisë, gjithçka dinin e dinin ilegalisht, sepse ata duhej të fshiheshin për të parë televizion, dhe ata dinin vetëm përmes televizionit, por pastaj turistët dhe ndërkombëtarët e parë erdhën, dhe ata u çmendën nga kurioziteti.

Imagjinojeni kur shkova atje në vitin '92, Hotel Daiti, i cili tani mendoj se është mbyllur, nuk e di, ndoshta janë duke e rinovuar, nuk ishte i hapur për publikun, kur shkova atje, përgjatë verës vinin njerëzit në bluza pa mënga dhe pantofla nga fshatrat për të parë këtë Hotel Daitin, ku të gjithë njerëzit e mëdhenj shkonin, ishte e pabesueshme.

Pastaj e pashë Shqipërinë në shkëlqimin e saj, gjithë ato gjëra të bukura, deti, deti është shumë i bukur, mendoj, nga Dhermiu kalon në Sarandë, në Vlorë, shkon përgjatë bregdetit jugor, është diçka madhështore. Muzeu i Beratit, i cili fatekqësish ishte plaçkitur në vitin '97, dhe pastaj u plaçkit prapë gjatë telasheve të vitit '98, por është shumë i bukur, me veprat e Onufrit, me atë kishën shumë të bukur Ortodokse. Në Fier është një manastir i cili iu ishte kthyer murgjive ortodoksë, por ata e kishin shndërruar në restaurant, kisha është shumë e bukur me afreska, në kohën e Enver Hoxhës atë e përdornin si hambar, imagjinoje! Kështuqë, pashë pjesën e bukur të Shqipërisë. Jugu është i veçantë, aq i bukur saqë tani kur shkoj në pushime, nuk shkoj në Itali por shkoj në bregdet në Shqipëri.

Dhe një mëngjes zgjohem dhe i them vetes, "Beh, pse nuk shkoj në Kosovë?" Më lejoni të përmend se gjatë ekzodit në Kosovë ne kishim strehuar, partneri im dhe unë - ne kishim një tavernë të vogël nën restaurantin tonë e cila ishte e rezervuar për evenete si datëlindjet dhe ishte poaq e madhe sa vetë restauranti, me dy banjo, kishte gjithçka për të qenë e vetë-përbajtshme-, ne kishim streuar një familje rej 15 njerëzish nga Prizreni, praktikisht dy të rritur dhe të tjerët ishin fëmijë. Pra, Kosova, 'E di ku jetojnë, mund të shkoj në Kosovë. Ndalem tek Xhemë, i vetmi njeri që shoqëronte gjithë atë familje, do ta pyes dhe pastaj do të shkoj në Prishtinë.'

Tashmë kam trembëdhjetë vjet që jam në Kosovë, nuk dua të kthehem në Itali, atje jam mirë për pesëmbëdhjetë ose njëzetë ditë, por nuk ndihem si në shtëpi më, është një botë komplet tjetër. Këtu dal, bëj blerjet në një dyqan të vogël, i cili është i hapur nga e hëna në të dielën afér shtëpisë sime. Fëmijët më thërrasin teta Antonella, e gjithë lagjja më njeh. *farë do të bëja në Itali? Të shtuneve do të

shkola në supermarket për të bërë blerjet e tërë javës, dhe pastaj do të më duhej ta hidhja gjysmën e frigoriferit, jo, atje nuk ndihem si në shtëpi më.

Projektet e mia...Të thashë tashmë, ndoshta është gjë e shëmtuar për t'u thënë, por tashmë iu kam thënë fëmijëve [kamarierëve] të mi, "Sigurisht unë do të vdes këtu". Restauranti do të jetë i tyre sepse askush nga familja ime nuk do të vijë nga Italia, muret nuk janë të miat por çfarëdo që është brenda këtij restauranti është e tyre, adhe ata mund të bëjnë çfarë të duan me të. Ata duhet të më varrosin mua këtu, është një fshat shumë i bukur afër Prizrenit në anën e djathtë, po, në anën e djathtë, në mes të Prizrenit dhe Gjakovës është një varrezë shumë e bukur në male, një varrezë katolike. Do të shkoja edhe në një varrezë muslimane, për mua nuk është problem, jo. Ata duhet të më varrosin mua atje lart me një mbështjellës, një arkivol të thjeshtë, dhe kaq.